REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

31.10.2026

"Zbatimi i modeleve të duhura të organizimit dhe drejtimit, kontrolli i brendshëm i njësive ekonomike të biznesit dhe përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës"

Kjo tezë ka tre seksione:

Seksioni I:	18 Pyetje me alternativa (1 pikë secila)	Gjithsej 18 pikë
Seksioni II:	7 Pyetje me shtjellim (4 pikë secila)	Gjithsej 28 pikë
Seksioni III:	9 Ushtrime (6 pikë secili)	Gjithsej 54 pikë

PIKË TOTALE TË TEZËS: 100 Pikë

SEKSIONI I – PYETJE ME ALTERNATIVA (18 x 1 pikë)

1. Cila nga format e mëposhtme të organizimit të komitetit të auditimit është e lejuar?

a. Komitet i krijuar brenda departamentit të financës.
b. Komitet i përbërë nga administratorët ekzekutivë.
c. Komitet i emëruar nga shoqëria audituese.
d. Komitet i pavarur ose komitet i organit administrativ apo mbikëqyrës të njësisë ekonomike të audituar.
e. Komitet i përbërë nga përgjegjësit e departamenteve kryesore të biznesit.

Përgjigjja e saktë: Alternativa D

2. Gjatë monitorimit të kontrollit të brendshëm, komiteti i auditimit identifikon mangësi në sistemin e menaxhimit të rrezikut. Cili veprim është në përputhje me detyrat e tij?

a. Të monitorojë efektivitetin e sistemeve përkatëse dhe të rekomandojë masa për përmirësimin e tyre.
b. Të marrë përsipër kryerjen e të gjitha kontrolleve operative të përditshme.
c. Të zëvendësojë përgjithmonë funksionin e auditimit të brendshëm.
d. Të ndryshojë vetë regjistrimet kontabël të njësisë.
e. Të ndërtojë vetë nga e para një matricë vlerësimi rreziqesh

Përgjigjja e saktë: Alternativa A

3. Administratori i një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar "SHPK" synon të lidhë një kontratë me një shoqëri tjetër në të cilën ai ka interes personal financiar. Cili është detyrimi i tij sipas Ligjit 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" (Ndryshuar me ligjin nr. 10475, datë 27.10.2011; nr. 129/2014, datë 2.10.2014)" nenit 13 "Ndalimi, konflikti i interesit dhe personat e lidhur"?

a. Të lidhë kontratën pa njoftim, nëse vlera e saj është e vogël.
b. Të deklarojë interesin dhe të marrë autorizimin e kërkuar sipas ligjit përpara kryerjes së veprimit.
c. Të marrë vetëm miratimin e kontabilistit të shoqërisë.
d. Të kërkojë autorizim vetëm pas ekzekutimit të kontratës.
e. Të mos deklarojë interesin personal financiar sepse do të ndëshkohet.

Përgjigjja e saktë: Alternativa B

4. Sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" (Ndryshuar me ligjin nr. 10475, dat 27.10.2011; nr. 129/2014, datë 2.10.2014) nenit 134 "Organet dhe publikimi", një shoqëri aksionare mund të organizohet:

a. Me sistem administrimi me një nivel ose me dy nivele.
b. Vetëm me këshill mbikëqyrës.
c. Me administrator të vetëm.
d. Vetëm me komitet auditimi.
e. Vetëm me një pronar si vetë pronësi

Përgjigjja e saktë: Alternativa A

5. **Sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" (Ndryshuar me ligjin nr. 10475, datë 27.10.2011; nr. 129/2014, datë 2.10.2014 nenit 135 "Të drejtat dhe detyrimet", cili organ ka kompetencën për të miratuar zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të një SHA-je, sipas kërkesave të ligjit?**

a. Komiteti i auditimit.
b. Drejtori i kontabilitetit.
c. Vetëm administratori ekzekutiv.
d. Asambleja e përgjithshme.
e. Audituesi i jashtëm i pasqyrave financiare.

Përgjigjja e saktë: Alternativa D

6. **Cili prej elementëve të mëposhtëm NUK është komponent i sistemit të kontrollit të brendshëm sipas Komitetit të Organizatave Sponsorizuese të Komisionit të Tregtisë apo emërtuar shkurt si "COSO"?**

a. Mjedisi i kontrollit.
b. Kontrollet e përgjithshme të Teknologjisë së informacionit ("TI").
c. Vlerësimi i rrezikut.
d. Informacioni dhe komunikimi.
e. Aktivitetet e monitorimit.

Përgjigjja e saktë: Alternativa B

7. **Cili nga kontrollet e mëposhtme është kontroll parandalues i automatizuar?**

a. Rishikimi mujor i raportit të shitjeve.
b. "ERP" Enterprise Resource Planning apo Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjes refuzon regjistrimin e një fature blerjeje pa porosi të miratuar.
c. Rakordimi bankar mujor.
d. Analiza e devijimeve buxhet–fakt.
e. Inventarizimi fizik në fund të vitit.

Përgjigjja e saktë: Alternativa B

8. **Sipas SNA 315 "Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij (i rishikuar)", Mjedisi i kontrollit përfshin të gjithë elementët e mëposhtëm përveç:**

a. Komunikimi dhe detyrimi për zbatimin e vlerave etike dhe të integritetit
b. Angazhimi për të mbajtur kompetencën profesionale
c. Pjesëmarrja e personave të ngarkuar me qeverisjen e entitetit
d. Filozofia e drejtimit dhe stili i operimit
e. Vlerësimi i rrezikut te biznesit

Përgjigjja e saktë: Alternativa E

9. **Kur kontrollet e përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit "TI" për manaxhimin e ndryshimeve janë joefektive, audituesi:**

a. Mbështetet plotësisht te kontrollet e automatizuara.
b. Nuk kryen asnjë procedurë mbi TI.
c. Shpreh automatikisht opinion me rezervë.
d. Nuk mund të mbështetet te kontrollet e automatizuara pa testime shtesë dhe zgjeron procedurat thelbësore.
e. Heq dorë nga angazhimi.

Përgjigjja e saktë: Alternativa D

10. Cili nga kontrollet e mëposhtme është kontroll aplikacioni (dhe jo kontroll i përgjithshëm i Teknologjisë së Informacionit ("TI")?

a. Kontrolli automatik i ekzistencës së kodit të klientit gjatë faturimit.
b. Procedura e miratimit të ndryshimeve të programeve.
c. Rishikimi tremujor i të drejtave të përdoruesve.
d. Kopjet rezervë ditore të bazës së të dhënave.
e. Ndarja e mjedisit të testimit nga mjedisi i prodhimit.

Përgjigjja e saktë: Alternativa A

11. Një shoqëri aksionare me sistem administrimi me një nivel synon të krijojë një Këshill Administrimi me pesë anëtarë. Cila nga përbërjet e mëposhtme përmbush kërkesën ligjore për shumicën e anëtarëve të pavarur dhe të ndryshëm nga administratorët?

a. Dy anëtarë të pavarur dhe tre administratorë.
b. Dy anëtarë të pavarur dhe tre anëtarë jo të pavarur, që nuk janë administratorë.
c. Tre anëtarë të pavarur, të ndryshëm nga administratorët, dhe dy administratorë.
d. Dy anëtarë të pavarur, një administrator dhe dy anëtarë të tjerë jo të pavarur.
e. Një anëtar i pavarur dhe katër anëtarë jo të pavarur, që nuk janë administratorë.

Përgjigjja e saktë: Alternativa C

12. Statuti i një shoqërie aksionare parashikon se një anëtar i Këshillit të Administrimit nuk mund të shkarkohet përpara përfundimit të mandatit të tij trevjeçar. Asambleja e Përgjithshme kërkon shkarkimin e një anëtari të zgjedhur prej saj, përpara përfundimit të mandatit. Cili është vlerësimi i saktë?

a. Shkarkimi mund të bëhet vetëm me vendim gjykate.
b. Asambleja mund ta shkarkojë në çdo kohë, me shumicë të thjeshtë votash, pavarësisht kufizimit statutor.
c. Shkarkimi kërkon domosdoshmërish miratimin e të gjithë aksionarëve.
d. Shkarkimi mund të bëhet vetëm nëse anëtari ka kryer një shkelje penale.
e. Shkarkimi nuk lejohet përpara përfundimit të mandatit trevjeçar.

Përgjigjja e saktë: Alternativa B

13. Një shoqëri aksionare e lidh bonusin vjetor të drejtuesve me rritjen e të ardhurave nga shitjet. Gjatë dy viteve të fundit, të ardhurat janë rritur, por marzhi i fitimit është ulur dhe periudha mesatare e arkëtimit është zgjatur. Bordi kërkon të ndryshojë skemën e shpërblimit për të shmangur nxitjen e rezultateve afatshkurtra në dëm të qëndrueshmërisë financiare. Cili nga propozimet e mëposhtme e trajton më plotësisht problemin e identifikuar?

a. Ruajtja e rritjes së shitjeve si tregues kryesor, duke shtuar një prag minimal për fitimin vjetor.
b. Zëvendësimi i rritjes së shitjeve me fitimin neto vjetor si kriter të vetëm të bonusit.
c. Kombinimi i rritjes së të ardhurave me marzhin e fitimit, cilësinë e arkëtimeve dhe objektiva afatgjata të performancës.
d. Lidhja e bonusit me fluksin neto të parasë nga aktiviteti, duke hequr treguesit e përfitueshmërisë.
e. Përdorimi i një mesatareje dyvjeçare të shitjeve për të reduktuar ndikimin e luhatjeve vjetore.

Përgjigjja e saktë: Alternativa C

14. Një shoqëri aksionare synon të shpërblejë drejtuesit ekzekutivë përmes opsioneve mbi aksione. Bordi kërkon që skema të nxisë rritjen e qëndrueshme të vlerës së aksioneve dhe të kufizojë përfitimin nga rritjet afatshkurtra të vlerës tyre. Cila nga alternativat e mëposhtme e përmbush më plotësisht këtë objektiv?

a. Dhënia e opsioneve në fillim të vitit, me të drejtë ushtrimi pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore.
b. Përcaktimi i numrit të opsioneve sipas fitimit vjetor, pa kushte të mëtejshme për periudhën e mbajtjes.
c. Kushtëzimi i përfitimit të opsioneve vetëm me rritjen e çmimit të aksioneve në fund të vitit.
d. Shtyrja e datës së dhënies së opsioneve, duke ruajtur si kriter të vetëm performancën vjetore.
e. Kushtëzimi i përfitimit përmes objektivave shumëvjeçare dhe një periudhe përfitimi gradual.

Përgjigjja e saktë: Alternativa E

15. Sipas SNA 315" Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij (i rishikuar)" cila prej alternativave më poshtë është e saktë lidhur me Aktivitetet e kontrollit?

a. Aktivitetet e kontrollit, të përshtatshme për një auditim mund të kategorizohen si politikat dhe procedurat që i përkasin Rishikimeve të performancës dhe përpunimit të informacionit.
b. Aktivitetet e kontrollit, të përshtatshme për një auditim mund të kategorizohen si politikat dhe procedurat që i përkasin Rishikimeve të performancës, përpunimit të informacionit dhe kontrollet fizike.
c. Aktivitetet e kontrollit, të përshtatshme për një auditim mund të kategorizohen si politikat dhe procedurat që i përkasin kontrolleve fizike dhe përpunimit të informacionit.
d. Aktivitetet e kontrollit, të përshtatshme për një auditim mund të kategorizohen si politikat dhe procedurat që i përkasin rishikimeve të performancës, përpunimit të informacionit, kontrollet fizike dhe ndarjes se detyrave.
e. Aktivitetet e kontrollit, të përshtatshme për një auditim mund të kategorizohen si politikat dhe procedurat që i përkasin rishikimeve të performancës dhe ndarja e detyrave.

Përgjigjja e saktë: Alternativa D

16. Kontrolli i sekuencës numerike të faturave të shitjes për boshllëqe dhe dublime adreson kryesisht pohimin për:

a. Plotësinë (dhe ndodhjen për dublimet).
b. Vlerësimin.
c. Paraqitjen.
d. Të drejtat dhe detyrimet.
e. Kontrolli nuk adreson asnjë pohim pasi lidhet me kontrollet e brendshme

Përgjigjja e saktë: Alternativa A

17. Sipas SNA 315 "Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij (i rishikuar)", procesi i vlerësimit të rrezikut të entitetit përfshin mënyrën se si drejtimi identifikon rreziqet e biznesit që lidhen me përgatitjen e pasqyrave financiare. Cila prej alternativave është e pasaktë si shembull i një rrethane që mund të sjellë rreziqe biznesi?

a. Ndryshimet në mjedisin e funksionimit
b. Personel i ri
c. Sistemet e informacionit të reja ose të rinovuar
d. Rritja e shpejtë
e. Forcimi i mëtejshëm i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Përgjigjja e saktë: Alternativa E

18. Cila nga alternativat e mëposhtme NUK është një rrezik që rrjedh nga përdorimi i Teknologjisë së Informacionit TI-së sipas SNA 315 "Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij" (i rishikuar)?

a) Akses i paautorizuar në të dhëna
b) Ndryshime të paautorizuara në skedarët bazë
c) Ndërhyrje manuale e papërshtatshme në përpunim
d) Gjykim i gabuar i drejtimit mbi supozimet ekonomike të një çmuarjeje
e) Ndërhyrje e paautorizuar në fjalëkalime

Përgjigjja e saktë: Alternativa D

SEKSIONI II – PYETJE ME SHTJELLIM (7 pyetje x 4 pikë secila pyetje)

Pyetja 1.

Shoqëria "ABC" sh.p.k. ka realizuar një rritje të fitimit nga aktiviteti i shfrytëzimit gjatë vitit, por njëkohësisht ka evidentuar rritje të ankesave të klientëve dhe të numrit të produkteve me defekt.

Kërkohet:

a) Shpjegoni në parim dallimin ndërmjet treguesve financiarë dhe jofinanciarë të performancës.
b) Në shembullin e dhënë, identifikoni treguesit jofinanciarë që shoqëria duhet të monitorojë.
c) Shpjegoni pse rritja e fitimit nga aktiviteti i shfrytëzimit nuk nënkupton domosdoshmërisht përmirësimin e performancës afatgjatë të shoqërisë.

Zgjidhje:

(a) Dallimi

- **Treguesit financiarë** maten në vlerë monetare dhe nxirren nga sistemi kontabël (fitimi, marzhi, ROCE, rritja e të ardhurave, likuiditeti). Janë objektivë dhe të krahasueshëm, por kryesisht historikë/vonues: tregojnë rezultatin e vendimeve të kaluara dhe nxisin fokusin afatshkurtër.
- **Treguesit jofinanciarë** maten në njësi fizike, përqindje ose kohë (cilësia, kënaqësia e klientit, koha e dorëzimit, produktiviteti, inovacioni). Janë tregues paraprijës: sinjalizojnë performancën e ardhshme financiare dhe lidhen drejtpërdrejt me faktorët kritikë të suksesit. Janë më të vështirë për t'u matur dhe krahasuar.
- Të dy llojet duhet të përdoren së bashku (p.sh. "Balanced Scorecard" - perspektivat financiare, e klientit, e proceseve të brendshme dhe e mësimit/rritjes).

(b) Treguesit jofinanciarë që duhet të monitorohen:

- numri i ankesave të klientëve (absolut dhe për 1.000 njësi të shitura) dhe koha e zgjidhjes së tyre;
- përqindja e produkteve me defekt / shkalla e skartimit dhe e ripunimit;
- kthimet e mallrave dhe pretendimet në garanci;
- indeksi i kënaqësisë së klientit, shkalla e mbajtjes dhe e humbjes së klientëve, klientët e përsëritur;
- dorëzimet në kohë, rezultatet e kontrollit të cilësisë së furnitorëve dhe të inspektimeve të brendshme.

(c) Pse rritja e fitimit nuk nënkupton performancë afatgjatë

Fitimi është tregues afatshkurtër dhe historik. Rritja mund të vijë nga kursime në cilësi (materiale më të lira, kontroll më i dobët), që ulin kostot sot, por rritja e ankesave dhe e defekteve paralajmëron humbjen e klientëve, dëmtimin e reputacionit, kosto të ardhshme garancie/kthimesh dhe rënie të shitjeve në periudhat pasardhëse. Pra, treguesit jofinanciarë po sinjalizojnë përkeqësim që ende nuk duket në fitim.

Pyetja 2.

Sipas SNA 315 "Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij" (i rishikuar), audituesi duhet të njohë sistemin e informacionit të njësisë ekonomike që lidhet me përgatitjen e pasqyrave financiare.

Kërkohet:

a) Shpjegoni cilat aspekte të sistemit të informacionit duhet të kuptojë audituesi;
b) Çfarë përfshin "mjedisi i Teknologjisë së Informacionit "TI"-së" i njësisë ekonomike.

Zgjidhje:

(a) Aspektet që duhet të kuptojë audituesi

- si iniciohen, regjistrohen, përpunohen, korrigjohen sipas nevojës, transferohen në librin e madh dhe raportohen transaksionet e rëndësishme (flukset e informacionit);
- regjistrimet kontabël, llogaritë specifike në pasqyrat financiare dhe dokumentet mbështetëse (elektronike ose në letër);
- procesi i raportimit financiar, përfshirë mbylljen e periudhës, regjistrimet ditar standarde dhe jo-standarde, çmuarjet kontabël dhe shënimet shpjeguese;
- informacioni i marrë jashtë librit të madh dhe librave ndihmës (sisteme të tjera, burime të jashtme);
- burimet e njësisë, përfshirë mjedisin e TI-së, që mbështesin sistemin e informacionit.

(b) Mjedisi i TI-së

Politikat dhe procedurat që zbaton njësia, si dhe infrastruktura dhe aplikacionet që përdor për të mbështetur operacionet dhe strategjitë e biznesit:

- **aplikacionet e TI-së -** programet për iniciimin, përpunimin, regjistrimin dhe raportimin e transaksioneve (ERP, paga, faturim elektronik), përfshirë fletët e përllogaritjes;
- **infrastruktura e TI-së -** rrjeti, sistemet operative, bazat e të dhënave, hardueri dhe softueri përkatës;
- **proceset e TI-së -** menaxhimi i aksesit, menaxhimi i ndryshimeve në programe dhe menaxhimi i operacioneve të TI-së, si dhe stafi i TI-së.

Pyetja 3.

Një shoqëri aksionare, e cila nuk është njësi ekonomike me interes publik, është në procesin e auditimit të pasqyrave financiare vjetore. Gjatë vitit, shoqëria e auditimit ka ofruar edhe shërbime këshillimi për përmirësimin e procedurave administrative të klientit, pa marrë pjesë në vendimmarrjen e drejtimit, pa hartuar regjistrimet kontabël dhe pa projektuar ose zbatuar kontrollet e raportimit financiar.
Këshilli Mbikëqyrës është informuar për shërbimet shtesë, por nuk ka kërkuar informacion mbi vlerësimin e kërcënimeve të mundshme ndaj pavarësisë së audituesit.

Kërkohet:

a) Vlerësoni ndikimin e mundshëm të shërbimeve të përshkruara në pavarësinë e audituesit të jashtëm, duke argumentuar përfundimin tuaj në bazë të rrethanave të rastit.
b) Analizoni përgjegjësitë përkatëse të audituesit dhe të Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me ruajtjen e pavarësisë gjatë angazhimit të auditimit.

Zgjidhje:

a) Vlerësimi i ndikimit në pavarësinë e audituesit

Ofrimi i shërbimeve të këshillimit për një klient auditimi mund të krijojë kërcënime ndaj pavarësisë, të cilat duhet të identifikohen dhe vlerësohen në varësi të natyrës së shërbimeve, përgjegjësive të marra përsipër dhe ndikimit të mundshëm në auditim. Në rastin konkret, mund të lindë një kërcënim i interesit vetjak, nëse të ardhurat nga shërbimet shtesë krijojnë varësi ekonomike ose ndikojnë në objektivitetin e audituesit. Gjithashtu, mund të lindë një kërcënim i vetërishikimit, nëse rezultatet e këshillimit ndikojnë në informacionin financiar ose në kontrollet që audituesi duhet të vlerësojë gjatë auditimit.

Nga faktet e paraqitura nuk rezulton që shoqëria e auditimit të ketë marrë përgjegjësi të drejtimit, të ketë hartuar regjistrime kontabël apo të ketë projektuar ose zbatuar kontrolle të raportimit financiar. Këto rrethana nuk tregojnë, në vetvete, një cenim të pavarësisë. Megjithatë, ato nuk përjashtojnë nevojën për vlerësimin e kërcënimeve të mundshme. Për rrjedhojë, shërbimet e përshkruara nuk mund të konsiderohen automatikisht të papajtueshme me pavarësinë e audituesit. Audituesi duhet të identifikojë dhe vlerësojë kërcënimet përkatëse dhe të përcaktojë nëse ato janë në një nivel të pranueshëm.

b) Përgjegjësitë e audituesit dhe të Këshillit Mbikëqyrës

Audituesi dhe shoqëria e auditimit kanë përgjegjësinë të ruajnë pavarësinë dhe të zbatojnë kuadrin konceptual të Kodit Ndërkombëtar të Etikës të IESBA-s. Ata duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë kërcënimet që lidhen me shërbimet e këshillimit dhe, nëse këto kërcënime nuk janë në një nivel të pranueshëm, të eliminojnë rrethanat që i krijojnë ose të zbatojnë masa mbrojtëse të përshtatshme, kur ato janë të disponueshme dhe efektive. Nëse kërcënimet nuk mund të eliminohen ose të reduktohen në një nivel të pranueshëm, shërbimi përkatës nuk duhet të ofrohet ose të vijojë.

Këshilli Mbikëqyrës, në kuadër të përgjegjësive të tij mbikëqyrëse, duhet të interesohet për natyrën e shërbimeve shtesë dhe ndikimin e mundshëm të tyre në pavarësinë e audituesit, duke kërkuar informacion mbi vlerësimin e kërcënimeve dhe mënyrën e trajtimit të tyre. Vetëm informimi për ekzistencën e shërbimeve nuk përbën domosdoshmërisht një shqyrtim të mjaftueshëm të çështjes. Megjithatë, përgjegjësia profesionale për respektimin e kërkesave të pavarësisë mbetet te audituesi dhe shoqëria e auditimit dhe nuk transferohet te Këshilli Mbikëqyrës.

Pyetja 4.

Një shoqëri përdor një sistem për regjistrimin e shitjeve dhe një program tjetër për kontabilitetin. Në fund të çdo dite, të dhënat e shitjeve eksportohen në një skedar dhe importohen manualisht në programin kontabël. Nuk kryhet rakordim i dokumentuar ndërmjet raportit të shitjeve dhe regjistrimeve në kontabilitet.

Kërkohet:

a) Shpjegoni dy rreziqe për raportimin financiar që krijon kjo mënyrë e transferimit të të dhënave.
b) Propozoni dy kontrolle që do të ndihmonin në sigurimin e plotësisë dhe saktësisë së informacionit të transferuar.

Zgjidhje:

a) Rreziqet për raportimin financiar

Rreziku i parë është transferimi jo i plotë i të dhënave, kur një pjesë e transaksioneve të shitjes nuk importohet në kontabilitet, duke sjellë mundësinë e nënvlerësimit të të ardhurave.

Rreziku i dytë është transferimi i pasaktë ose i dyfishtë i transaksioneve, për shkak të gabimeve gjatë eksportimit, ndryshimit të skedarit ose importimit manual, duke sjellë mundësinë e regjistrimit të pasaktë të të ardhurave.

b) Kontrollet për plotësinë dhe saktësinë e informacionit (pranohen dy nga sa vijon)

- Një kontroll është rakordimi ditor, i dokumentuar, ndërmjet numrit dhe vlerës totale të transaksioneve në sistemin e shitjeve dhe atyre të regjistruara në kontabilitet, duke identifikuar dhe trajtuar çdo diferencë.
- Një kontroll tjetër është verifikimi i rezultateve të çdo importimi, përmes kontrollit të numrit të transaksioneve të pranuara dhe të refuzuara, identifikimit të gabimeve gjatë importimit dhe korrigjimit të tyre përpara përfundimit të procesit.
- Kontroll i sekuencës numerike të faturave për boshllëqe dhe dublime në kontabilitet; sistemi të refuzojë importin e faturave ekzistuese;
- Mbrojtje e skedarit (format vetëm-lexim, akses i kufizuar, checksum) dhe log i importeve;
- Raport i përjashtimeve/gabimeve të importit, i rishikuar dhe sistemuar çdo ditë;

Zgjidhja afatgjatë: ndërfaqe e automatizuar (integrim) ndërmjet dy sistemeve.

Pyetja 5.
Gjatë auditimit të një shoqërie, drejtuesi i financës i shpjegon audituesit se çdo rakordim bankar duhet të shqyrtohet dhe miratohet nga një person tjetër, sipas procedurës së miratuar. Audituesi merr procedurën e shkruar dhe konfirmimin verbal të drejtuesit, por nuk shqyrton rakordime të kryera dhe nuk verifikon nëse kontrolli është zbatuar.

Kërkohet:

a) Shpjegoni dallimin ndërmjet hartimit të përshtatshëm të një kontrolli dhe zbatimit të tij.
b) Vlerësoni nëse evidenca e marrë nga audituesi është e mjaftueshme për të përcaktuar zbatimin e kontrollit dhe shpjegoni një procedurë shtesë të përshtatshme.

Zgjidhje:

a) Dallimi ndërmjet projektimit dhe zbatimit të kontrollit
Vlerësimi i hartimit synon të përcaktojë nëse kontrolli, duke supozuar se funksionon siç është hartuar, është i aftë, individualisht ose së bashku me kontrolle të tjera, të parandalojë ose të zbulojë dhe korrigjojë anomali materiale. Vlerësimi i zbatimit synon të përcaktojë nëse kontrolli ekziston dhe nëse njësia ekonomike e ka vënë në përdorim në praktikë.

b) Mjaftueshmëria e evidencës dhe procedura shtesë
Procedura e shkruar dhe konfirmimi verbal i drejtuesit të financës nuk janë të mjaftueshme, më vete, për të përcaktuar nëse kontrolli është zbatuar në praktikë. Sipas SNA 315, vetëm kërkimi i informacionit nuk është i mjaftueshëm për të vlerësuar zbatimin e një kontrolli. Audituesi duhet të kryejë një procedurë shtesë, për shembull, të inspektojë një rakordim bankar të përgatitur dhe evidencën që dokumenton shqyrtimin dhe miratimin e tij nga një person tjetër, sipas procedurës së miratuar. Ky verifikim shërben për të përcaktuar zbatimin e kontrollit dhe nuk është i barasvlershëm me testimin e efektivitetit operacional të tij gjatë gjithë periudhës.

Pyetja 6.
Sistemi i informacionit kontabël i një shoqërie tregtare është i ndërtuar mbi një bazë të dhënash relacionale, me module për shitjet, blerjet, inventarin dhe librin e madh.

Kërkohet:

a. Përshkruani përbërësit e sistemit të informacionit kontabël (hyrjet, përpunimi, ruajtja, daljet) dhe rolin e secilit në procesin e raportimit financiar.
b. Dalloni të dhënat bazë (master data) nga të dhënat e transaksioneve dhe shpjegoni pse një gabim në të dhënat bazë ka ndikim më të madh në pasqyrat financiare se një gabim në një transaksion të vetëm.
c. Përmendni rolin e integritetit referencial.

Zgjidhje:

(a) Përbërësit

- **Hyrjet (Inputet):** mbledhja dhe hedhja e të dhënave nga ~~dokumentet burim~~ dokumentet justifikuese (fatura, fletëhyrje, ekstrakte) - kontrolle validimi në hyrje;
- **Përpunimi:** llogaritjet, klasifikimi, kontabilizimi automatik në llogaritë përkatëse, kalimi nga modulet në librin e madh;
- **Ruajtja:** baza e të dhënave (skedarë bazë dhe transaksione), kopjet rezervë dhe arkivimi - siguron ruajtjen dhe gjurmën e auditimit;
- **Daljet (outputet):** bilanci vërtetues, pasqyrat financiare, raportet e drejtimit dhe deklaratat tatimore.

(b) Të dhënat bazë dhe të dhënat e transaksioneve

Të dhënat bazë (master data) janë relativisht të përhershme dhe përdoren në shumë transaksione: kartela e klientit/furnitorit (NIPT, IBAN, kushtet e pagesës, limiti i kreditit), artikujt dhe çmimet, planin kontabël, punonjësit dhe pagat bazë. Të dhënat e transaksioneve regjistrojnë ngjarje të veçanta (një faturë, një pagesë). Një gabim në të dhënat bazë përsëritet automatikisht në çdo transaksion që i përdor (p.sh. çmim i gabuar, normë e gabuar amortizimi, IBAN i ndryshuar qëllimisht në mënyrë mashtruese), prandaj ka efekt sistematik dhe kumulativ, ndërsa gabimi në një transaksion ka efekt të kufizuar.

(c) Integriteti referencial

Rregull i bazës relacionale që siguron që çdo çelës i jashtëm të referojë një regjistrim ekzistues: p.sh. nuk mund të regjistrohet faturë për një furnitor që nuk ekziston në skedarin bazë, dhe nuk mund të fshihet një furnitor që ka transaksione. Kështu parandalohen regjistrimet "obsolete", boshe ose "jetime", ruhet konsistenca ndërmjet moduleve dhe gjurma e auditimit.

Pyetja 7.

Sipas SNA 315 "Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij" (i rishikuar), shpjego shkurtimisht çfarë janë Aktivitetet e Kontrollit dhe si kategorizohen ato?

Zgjidhje:

Aktivitetet e kontrollit janë politikat dhe procedurat që ndihmojnë për t'u siguruar se janë zbatuar direktivat e drejtimit. Aktivitetet e kontrollit, si në formën e sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI) apo të sistemeve manuale, kanë disa objektiva dhe aplikohen në nivele të ndryshme organizative dhe funksionale.
Shembuj të aktiviteteve të veçanta te kontrollit përfshijnë:

- **Rishikimin e performancës**

Këto aktivitete kontrolli përfshijnë rishikimin dhe analizën e performancës aktuale kundrejt buxheteve, parashikimeve dhe performancës së periudhave të mëparshme; duke krahasuar grupe të ndryshme të të dhënave-operative apo financiare - me njëra tjetrën, së bashku me analizën e relacioneve dhe kryerjen e veprimeve investiguese e korrigjuese; duke krahasuar të dhënat e brendshme me burimet e jashtëme të informacionit; dhe rishikimin e përformancës funksionale apo të aktivitetit.

- **Përpunimin e informacionit.**

Dy grupimet e gjëra të sistemeve të informacionit për aktivitetet e kontrollit janë kontrolli i programeve, i cili zbatohet në përpunimin e programeve individuale dhe kontrollet e përgjithshme të sistemeve TI, të cilët janë politika dhe procedura që lidhen me shumë programe, si dhe mbështesin funksionimin në mënyrë efektive të kontrolleve të programeve duke ndihmuar që të sigurohet funksionimi në vazhdimësi dhe si duhet i sistemeve të informacionit

- **Kontrollet fizike.**

Kontrolle që përfshijnë:
○ Sigurimin fizik të aktiveve duke përfshirë masat e duhura mbrojtëse siç janë paisjet e sigurisë mbi të drejtën e hyrjes në aktivet dhe regjistrat.
○ Autorizimin për të drejtën e hyrjes në programet e kompjuterit dhe dosjet e të dhënave.

○ Numërimin periodik e krahasimin me shumat e treguara nga regjistrat e kontrollit (për shembull krahasimi i rezultateve të inventarizimit të gjendjes së parasë, letrave me vlerë dhe i inventarëve me shumat në regjistrimet kontabël).

• Ndarjen e detyrave.

Realizohet duke ju dhënë njerëzve të ndryshëm përgjegjësi për autorizimin e transaksioneve, regjistrimin e tyre dhe mbajtjen e sigurtë të aktiveve. Ndarja e detyrave synon të kufizojë oportunitetet që lejojnë cilindo punonjës të mund të realizojë si kryerjen ashtu edhe korigjimin e gabimeve apo mashtrimin gjatë kryerjes së zakonshme të detyrës.

SEKSIONI III - USHTRIME (9 Ushtrime x 6 pikë secili)

Ushtrimi 1.

Kodet e klientëve në sistemin ERP kanë 5 shifra: 4 shifra bazë dhe një shifër kontrolli në fund. Shifra e kontrollit llogaritet me metodën "modulus 11" (shifrat bazë shumëzohen, nga e majta në të djathtë, me peshat 5, 4, 3, 2; prodhimet mblidhen; gjendet mbetja e pjesëtimit të shumës me 11; shifra e kontrollit = 11 – mbetja). Nëse rezultati është 11, shifra e kontrollit është 0; nëse rezultati është 10, kodi bazë nuk përdoret.

Kërkohet:

a. Llogaritni shifrën e kontrollit për klientin e ri me kod bazë 3728.
b. Gjatë regjistrimit të faturave, operatorët hodhën kodet e klientëve: 37821, 51403, 51903 dhe 26045. Verifikoni secilin kod dhe tregoni cili pranohet dhe cili refuzohet nga sistemi. Për kodin 37821, shpjegoni llojin e gabimit.
c. Vlerësoni çfarë lloj gabimesh nuk i zbulon shifra e kontrollit dhe me cilat kontrolle të tjera duhet të kombinohet.

Zgjidhje:

(a) Kodi bazë 3728

3×5 + 7×4 + 2×3 + 8×2 = 15 + 28 + 6 + 16 = 65; 65 : 11 = 5, mbetja 10; shifra e kontrollit = 11 − 10 = 1. Kodi i plotë: 37281.

(b) Verifikimi i kodeve

Kodi	Llogaritja	Shuma	Mbetja	Shifra e saktë	Rezultati
37821	3×5+7×4+8×3+2×2	71	5	6	Refuzohet (shifra e dhënë 1)
51403	5×5+1×4+4×3+0×2	41	8	3	Pranohet
51903	5×5+1×4+9×3+0×2	56	1	10 → kod bazë i papërdorshëm	Refuzohet
26045	2×5+6×4+0×3+4×2	42	9	2	Refuzohet (kodi i vlefshëm do të ishte 26042)

Kodi 37821 është kodi i saktë për kodin bazë 37281 por me shifrat e treta dhe të katërta të ndërruara (8 dhe 2): pra kemi të bëjmë me gabim transpozimi. Për shkak se pozicionet kanë pesha të ndryshme, ndërrimi i shifrave ndryshon shumën e ponderuar të shifrave (71 në vend të 65 që do kishte qenë nëse transpozimi nuk do ishte bërë) dhe gabimi zbulohet. Kodi 51903 ka një gabim në një shifër (9 në vend të 4 - krahaso me 51403, ku shifra e kontrollit është sërish 3, por kodi bazë është ndryshe); kodi 26045 ka shifër kontrolli të gabuar (kodi i vlefshëm do të ishte 26042).

(c) Kufizimet dhe kontrollet plotësuese

- Shifra e kontrollit verifikon vetëm vlefshmërinë matematikore të kodit, jo ekzistencën ose korrektësinë e tij: një kod i vlefshëm i një klienti tjetër pranohet (faturë në klientin e gabuar).
- Nuk zbulon gabime të shumëfishta që kompensojnë njëra-tjetrën dhe gabime në fusha të tjera (sasia, çmimi, data, shuma).
- Kombinohet me: kontrollin e ekzistencës në skedarin bazë (lookup), shfaqjen e emrit/NIPT-it të klientit për konfirmim vizual, kontrolle formati dhe arsyeshmërie/limiti, kontrollin e sekuencës dhe dublimeve të faturave, totale kontrolli dhe miratimin e ndryshimeve në skedarin bazë të klientëve.

Ushtrimi 2.
"ABC" sh.p.k., shoqëri tregtare me 85 punonjës, përdor një sistem "ERP" Enterprise Resource Planning ose Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjes për kontabilitetin, blerjet dhe pagesat. Gjatë rishikimit të të drejtave të aksesit më 30.09.2026 rezultoi matrica e mëposhtme:

Përdoruesi	**Pozicioni**	**Të drejtat në** "ERP" Enterprise Resource Planning ose Planfikimi i Burimeve të Ndërmarrjes
A.B	Kontabiliste	Krijim/ndryshim furnitorësh në skedarin bazë; regjistrim faturash blerje; përgatitje urdhërpagesash
C.D	Administrator TI	Administrim sistemi; regjistrim dhe fshirje regjistrimesh në librin e madh
E.F	Llogari e përbashkët	Të gjitha të drejtat; fjalëkalimi njihet nga 3 punonjës të TI-së dhe financës
G.H	Ish-specialiste blerjesh (larguar më 15.06.2026)	Krijim porosish blerje; miratim fletëhyrjesh (llogaria aktive)
L.K	Drejtor financiar	Miratim pagesash; hapje/mbyllje periudhash kontabël; ndryshim parametrash kontabël
M.N	Magazinier	Regjistrim fletëhyrjesh dhe rregullime sasish inventari pa miratim

Kërkohet:

a) Identifikoni 6 (gjashtë) dobësi në administrimin e aksesit dhe rrezikun përkatës për raportimin financiar.
b) Propozoni masa korrigjuese në lidhje me dobësitë e identifikuara.

Zgjidhje:

(a) Dobësitë dhe rreziqet

Përdoruesi	Dobësia	Rreziku për raportimin financiar
A.B - Kontabiliste	Krijon furnitorë, regjistron fatura dhe përgatit pagesa - konflikt në ndarjen e detyrave.	Krijim furnitorësh fiktivë dhe pagesa të paautorizuara; mbivlerësim shpenzimesh, humbje mjetesh monetare (mashtrim).
C.D - Administrator TI	Stafi i TI-së regjistron dhe fshin regjistrime në librin e madh.	Ndryshime të paautorizuara në të dhëna financiare dhe fshirje gjurmësh; anashkalim i kontrolleve.
E.F - Llogari e përbashkët	Të gjitha të drejtat; fjalëkalimi njihet nga 3 persona.	Mungesë llogaridhënieje (nuk dihet kush ka vepruar), akses i pakufizuar, gjurmë auditimi e pavlefshme.
G.H - Ish-specialiste	Llogaria aktive pas largimit më 15.06.2026.	Akses i paautorizuar nga ish-punonjësja ose të tjerë; porosi/fletëhyrje fiktive.
L.K - Drejtor financiar	Miraton pagesa dhe ndryshon parametra dhe periudha kontabël.	Anashkalim i kontrolleve nga drejtimi; regjistrime në periudha të mbyllura; ndryshim parametrash pa kontroll.
M.N - Magazinier	Regjistron fletëhyrje dhe rregullon sasi inventari pa miratim.	Ruajtja fizike dhe regjistrimi te i njëjti person; fshehje e mungesave/vjedhjeve; inventar i mbivlerësuar.

(b) Masa korrigjuese

- rishikim i roleve sipas parimit të privilegjit minimal dhe ndarjes së detyrave: krijimi/ndryshimi i furnitorëve te person i pavarur nga pagesat; pagesat me miratim të dyfishtë;
- heqja e aksesit të stafit të TI-së në transaksionet e biznesit; aksesi privilegjuar vetëm për raste emergjente, i miratuar dhe i regjistruar (log);
- eliminimi i llogarive të përbashkëta dhe përdorimi i llogarive emërore për çdo përdorues, fjalëkalime të forta dhe MFA (autentifikim me shumë faktorë);
- çaktivizimi i menjëhershëm i llogarive pas largimit, me njoftim automatik nga burimet njerëzore te TI-ja; çaktivizim i menjëhershëm i llogarisë së G.H dhe rishikim i veprimeve pas 15.06.2026;
- ndryshimet e parametrave dhe rihapja e periudhave me miratim të dytë (p.sh. administratori) dhe raport i ndryshimeve; rregullimet e inventarit me miratim të përgjegjësit;
- rishikim tremujor i të drejtave të aksesit nga pronarët e proceseve dhe monitorim i log-eve.

Ushtrimi 3.

Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të "ABC" sh.a. për vitin e mbyllur më 31.12.2025, audituesi nxori nga "ERP" Enterprise Resource Planning ose Planfikimi i Burimeve të Ndërmarrjes të gjitha regjistrimet në ditar të vitit. Sipas politikës së shoqërisë, blerjet e Aktiveve Afatgjata Materiale mbi 10,000,000 lekë miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës. Punonjësi "A.B" është larguar nga puna më 31.07.2025.

Më poshtë janë tetë regjistrime shkëputur nga ditari:

Nr.	Data / ora	Përdoruesi	D / K	Shuma (lekë)	Përshkrimi
1	15.03.2025 10:20	kontabilist1	602 / 401	245,380	Faturë furnitori
2	31.12.2025 23:47	drejtori.f	411 / 701	15,000,000	Rregullim shitje
3	20.06.2025 (e shtunë) 14:05	admin_TI	512 / 758	3,200,000	Korrigjim
4	28.12.2025 09:15	Interface paga	641 / 421	4,812,650	Pagat e dhjetorit
5	02.01.2026 08:30	drejtori.f	701 / 411	15,000,000	Anulim rregullimi
6	30.12.2025 18:40	kontabilist1	215 / 404	9,999,000	Blerje pajisjesh
7	14.08.2025 11:00	A.B	467 / 512	1,800,000	Paradhënie
8	10.11.2025 12:10	kontabilist2	615 / 401	87,420	Mirëmbajtje

Shënim: Kolona e 4 (katërt) "D / K", i referohet llogarive orientuese kontabël

Kërkohet:

a) Identifikoni regjistrimet që paraqesin tregues rreziku dhe argumentoni zgjedhjen.
b) Përshkruani procedurat e auditimit të asistuara nga kompjuteri "CAAT (Computer Assisted Auditing Techniques)", që do të përdorni për testimin e të gjithë popullatës së regjistrimeve ditar.

Zgjidhje:

(a) Regjistrimet me tregues rreziku

Nr.	Treguesit e rrezikut
2	Regjistrim manual nga drejtimi, në ditën e fundit të vitit, në orën 23:47 (jashtë orarit), shumë e rrumbullakosur e plotë (15,000,000), përshkrim i paqartë ("Rregullim shitje"), rrit të ardhurat dhe mbart rrezikun e anashkalimit të kontrolleve nga drejtimi dhe i mbivlerësimit të të ardhurave (SNA 240).
5	Anullim i plotë i regjistrimit nr. 2 në ditën e parë të punës të vitit pasardhës. Tregues i manipulimit të ndarjes së periudhave (cut-off) dhe i "zbukurimit" të rezultatit; konfirmon rrezikun te nr. 2.
3	Regjistrim nga stafi i TI-së (që nuk duhet të ketë akses në transaksione), në ditë të shtunë, përshkrim i paqartë "Korrigjim", në llogari të ardhurash (758) me rritje të mjeteve monetare.
6	Shuma 9,999,000 është pak nën pragun e miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës (10,000,000); fund viti, jashtë orarit, rrezik i shmangies së autorizimit (ndarje e blerjes) ose kapitalizim i papërshtatshëm.
7	Regjistrim nga punonjësi A.B, i larguar më 31.07.2025 është akses i paautorizuar; dalje mjetesh monetare (paradhënie 1,800,000) si dhe ka rrezik mashtrimi.

Regjistrimet 1, 4 dhe 8 janë normale (shuma jo të rrumbullakosura, përdorues të autorizuar, orar normal; nr. 4 vjen nga ndërfaqja e automatizuar e pagave dhe testohet përmes kontrolleve të ndërfaqes).

(b) Procedurat CAAT për të gjithë popullatën

- Plotësia e të dhënave: rakordimi i totaleve të ekstraktit (debi/kredi, numri i regjistrimeve) me bilancin vërtetues dhe librin e madh; kontrolli i sekuencës së numrave të regjistrimeve për boshllëqe dhe dublime.
- Filtrim sipas kohës: regjistrime në fundjavë, festa, jashtë orarit, në ditët e fundit/të para të periudhës dhe regjistrime pas mbylljes së periudhës.
- Filtrim sipas përdoruesit: regjistrime nga administratorë TI, drejtues të lartë, përdorues që aksesojnë rrallë sistemin ose llogari të përbashkëta; krahasimi i listës së përdoruesve me listën e të larguarve nga burimet njerëzore (data e largimit kundrejt datës së regjistrimit).
- Filtrim sipas shumës: shuma të rrumbullakëta, shuma pak nën pragjet e autorizimit (p.sh. 9,000,000-9,999,999), analiza e shpërndarjes së shifrave (metoda Benford).
- Filtrim sipas llogarive: kombinime të pazakonta (të ardhura kundrejt bankës ose kundrejt llogarive të pezulluara), regjistrime manuale në llogari që zakonisht marrin të dhëna nga ndërfaqe, përshkrime të paqarta ("rregullim", "korrigjim").
- Storno dhe anulime: regjistrime të anuluara menjëherë pas fundvitit dhe çiftimi i tyre me regjistrimet origjinale.
- Për regjistrimet e përzgjedhura: inspektim i dokumenteve mbështetëse justifikuese dhe i miratimeve, diskutim me drejtimin dhe me të ngarkuarit me qeverisjen.

Ushtrimi 4.

Politika e shoqërisë kërkon sa më poshtë: çaktivizim të llogarisë në "ERP" Enterprise Resource Planning ose Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjes brenda 1 dite pune nga largimi i punonjësit; rishikim tremujor të përdoruesve; ndalim të llogarive të përbashkëta. Gjatë vitit 2025 nuk është kryer asnjë rishikim. Audituesi krahason listën e burimeve njerëzore me listën e llogarive aktive në "ERP" Enterprise Resource Planning ose Planfikimi i Burimeve të Ndërmarrjes më 31.12.2025:

Të dhëna	Numri
Llogari aktive në ERP Enterprise Resource Planning ose Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjes	132
Punonjës të larguar gjatë vitit 2025	14
Prej tyre, me llogari ende aktive	9
Llogari të punonjësve të larguar të përdorura pas datës së largimit	3
Llogari të përbashkëta ("arka", "magazina1", "admin", "test")	4

Nga log-et rezulton se njëra prej 3 llogarive të përdorura pas largimit ka regjistruar 5 veprime në ditar me vlerë totale 2,400,000 lekë. Niveli i materialitetit të performancës është 1,500,000 lekë. Burimet njerëzore nuk e njoftojnë TI-në për largimet.

Kërkohet:

a) Llogaritni: përqindjen e punonjësve të larguar me llogari aktive; numrin dhe përqindjen e llogarive të papërshtatshme ndaj totalit të llogarive aktive.
b) Vlerësoni mangësitë sipas komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm të shpallura nga Komiteti i Organizatave Sponsorizuese të Komisionit të Tregtisë "COSO" dhe ndikimin në raportimin financiar.
c) Shpjegoni procedurat që kryen audituesi në lidhje me mangësitë e identifikuara më sipër, si dhe konkluzionet e auditimit.

Zgjidhje:

(a) Llogaritjet

- Punonjës të larguar me llogari aktive: 9 / 14 = 64.3%.
- Llogari të papërshtatshme: 9 (të punonjësve të larguar) + 4 (të përbashkëta) = 13; 13 / 132 = 9.85% e llogarive aktive.
- Për informacion: 3 nga 9 llogaritë (33%) janë përdorur pas largimit; njëra ka regjistruar 5 veprime me vlerë 2,400,000 lekë, mbi materialitetin e performancës (1,500,000).

(b) Mangësitë sipas komponentëve COSO dhe ndikimi

Komponenti COSO	Mangësia
Mjedisi i kontrollit	Politika ekziston, por nuk zbatohet; mungon llogaridhënia për përgjegjësitë e kontrollit dhe linjat e përgjegjësisë HR (burime njerëzore) - TI).
Vlerësimi i rrezikut	Rreziku i aksesit të paautorizuar dhe i mashtrimit nuk është vlerësuar .
Aktivitetet e kontrollit	Llogaritë nuk çaktivizohen brenda 1 dite; ekzistojnë llogari të përbashkëta; KPTI (Kontrollet e përgjithshme të TI) të aksesit joefektive
Informacioni dhe komunikimi	Burimet njerëzore nuk njoftojnë TI-në për largimet; mungesë komunikimi të brendshëm
Aktivitetet e monitorimit	Asnjë rishikim tremujor gjatë 2025; mangësitë nuk zbulohen dhe nuk korrigjohen.

Ndikimi në raportimin financiar: transaksione të paautorizuara/fiktive pa llogaridhënie; gjurma e auditimit nuk identifikon personin; kontrollet e automatizuara që mbështeten te aksesi nuk janë të besueshme. Veprimet prej 2,400,000 lekësh tejkalojnë materialitetin e performancës, prandaj rreziku i anomalisë materiale (përfshirë mashtrimin) është i lartë. Mangësia vlerësohet si mangësi e rëndësishme.

(c) Procedurat e audituesit dhe konkluzionet

- nxjerrja me CAAT e të gjitha veprimeve të regjistruara nga 9 llogaritë e punonjësve të larguar pas datës së largimit dhe nga 4 llogaritë e përbashkëta;
- testimi 100% i 5 veprimeve (2,400,000 lekë): dokumentacioni mbështetës, miratimet, përfituesi, ekzistenca e mallit/shërbimit, IBAN-i; pyetje drejtimit; trajtim sipas SNA 240 nëse ka tregues mashtrimi;
- rivlerësimi i rrezikut: audituesi nuk mbështetet në kontrollet e aksesit dhe në kontrollet e automatizuara që varen prej tyre; zgjerimi i procedurave thelbësore;
- vlerësimi i anomalive sipas SNA 450, nëse veprimet nuk mbështeten, anomalia (2,400,000) kërkohet të korrigjohet; nëse nuk korrigjohet dhe është materiale, ndikon në opinion;
- komunikimi me shkrim i mangësisë së rëndësishme drejtimit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen (SNA 265); rekomandime: çaktivizim i menjëhershëm, proces automatik HR-TI, eliminimi i llogarive të përbashkëta, rishikime tremujore.

Konkluzioni: kontrolli i administrimit të aksesit nuk është efektiv; audituesi duhet të marrë evidencë thelbësore të mjaftueshme dhe të përshtatshme për transaksionet e ndikuara.

Ushtrimi 5.

Një shoqëri ka kontraktuar një ofrues të jashtëm shërbimi për përpunimin e listëpagesave. Shoqëria i dërgon çdo muaj të dhënat e punonjësve, ndërsa ofruesi përllogarit pagat, kontributet dhe përgatit skedarin për pagesat bankare.
Kontrata përcakton shërbimet që duhet të ofrohen, por nuk përshkruan përgjegjësitë për verifikimin e ndryshimeve të pagave. Shoqëria i pranon raportet mujore pa rakordim me të dhënat e burimeve njerëzore dhe pa shqyrtuar ndryshimet nga muaji i mëparshëm.

Kërkohet:

a) Vlerësoni nëse kontraktimi i procesit të përpunimit të listë pagesave e përjashton drejtimin e shoqërisë nga përgjegjësia për kontrollet përkatëse. Argumentoni përgjigjen.
b) Identifikoni dy kontrolle që duhet të mbeten përgjegjësi e shoqërisë, duke shpjeguar qëllimin e tyre.
c) Shpjegoni si duhet ta trajtojë audituesi përdorimin e ofruesit të jashtëm të shërbimit gjatë vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Zgjidhje:

a) Përgjegjësia e drejtimit për kontrollet përkatëse
Kontraktimi i përpunimit të listëpagesave te një ofrues i jashtëm nuk e përjashton drejtimin e shoqërisë nga përgjegjësia për raportimin financiar dhe për sistemin e kontrollit të brendshëm përkatës. Përgjegjësia e drejtimit nuk transferohet te ofruesi vetëm për shkak të kontraktimit të shërbimit.
Shoqëria mbetet përgjegjëse për vendosjen dhe zbatimin e kontrolleve të përshtatshme mbi informacionin që i transmeton ofruesit dhe mbi rezultatet e përpunimit, përfshirë autorizimin e ndryshimeve të pagave dhe verifikimin e listëpagesave të përgatitura.

b) Kontrollet që duhet të mbeten përgjegjësi e shoqërisë
Shoqëria duhet të zbatojë një kontroll për autorizimin dhe dokumentimin e ndryshimeve në pagat dhe të dhënat e punonjësve përpara transmetimit te ofruesi. Ky kontroll synon të parandalojë përpunimin e ndryshimeve të paautorizuara ose të pasakta.
Shoqëria duhet të kryejë rakordimin e listëpagesës së përgatitur nga ofruesi me të dhënat e miratuara të burimeve njerëzore dhe të shqyrtojë ndryshimet e pazakonta nga muaji i mëparshëm. Ky kontroll synon të identifikojë gabimet, mungesat ose ndryshimet e paautorizuara përpara miratimit të pagesave.

c) Trajtimi nga audituesi i përdorimit të ofruesit të jashtëm
Sipas SNA 402, audituesi duhet të kuptojë natyrën dhe rëndësinë e shërbimeve të ofruesit të jashtëm, proceset dhe transaksionet e ndikuara, rrjedhën e informacionit ndërmjet palëve, kushtet përkatëse të kontratës dhe ndikimin e shërbimit në sistemin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Ai duhet të identifikojë kontrollet përkatëse të shoqërisë dhe të vlerësojë projektimin dhe zbatimin e tyre, për të mbështetur identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale.
Audituesi duhet të përcaktojë nëse ka siguruar një kuptim të mjaftueshëm të shërbimit dhe të ndikimit të tij në kontrollin e brendshëm. Nëse informacioni i marrë nga shoqëria nuk është i mjaftueshëm, ai duhet të kryejë procedura të tjera të përshtatshme, si marrja e informacionit shtesë nga ofruesi ose verifikimi i kontrolleve përkatëse, për të kuptuar mënyrën se si
përpunohen listëpagesat dhe si kontrollohet saktësia e tyre. Rezultatet e këtij vlerësimi duhet të merren parasysh në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve dhe në planifikimin e procedurave të mëtejshme të auditimit.

Ushtrimi 6.

"ABC" sh.p.k. ka pronarin-administrator dhe tre punonjës në administratë. Znj. X, me përvojë 12-vjeçare në shoqëri, kryen këto detyra: dërgon porositë te furnitorët, pranon mallrat në magazinë, regjistron faturat në sistem, krijon furnitorët e rinj, përgatit dhe ekzekuton pagesat me e-banking (ka token-in e vetëm të shoqërisë) dhe kryen rakordimin bankar mujor. Gjatë vitit 2025 u zbulua se Znj. X kishte krijuar një furnitor fiktiv dhe i kishte paguar 12 fatura me vlerë mesatare 350,000 lekë secila, pa TVSH. Shpenzimet janë regjistruar si "Shërbime konsulence".

Kërkohet:

a) Identifikoni detyrat e papajtueshme në këndvështrimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
b) Llogaritni humbjen dhe efektin në pasqyrat financiare.
c) Propozoni ndarjen e detyrave ndërmjet tre punonjësve.
d) Propozoni kontrolle shtesë nga pronari, duke pasur parasysh madhësinë e shoqërisë.

Zgjidhje:

(a) Detyrat e papajtueshme
Znj. X kryen njëkohësisht: autorizimin (lëshimi i porosive, krijimi i furnitorëve të rinj), ruajtjen e aktiveve (marrja e mallrave, ekzekutimi i pagesave me token-in e vetëm), regjistrimin (faturat në sistem) dhe kontrollin/rakordimin (rakordimi bankar). Mungon plotësisht ndarja e detyrave; krijimi i furnitorit fiktiv, pagesa dhe fshehja në rakordim bëhen nga i njëjti person. Kombinimet më kritike: krijimi i furnitorëve + pagesat; pagesat + rakordimi bankar.

(b) Humbja dhe efekti
- Humbja = 12 × 350,000 = 4,200,000 lekë.
- Shpenzimet për "Shërbime konsulence" janë mbivlerësuar me 4,200,000 lekë, sepse nuk ka shërbim të marrë. Shuma duhet riklasifikuar si humbje nga mashtrimi (shpenzim tjetër). Nëse rikuperimi nga punonjësja është i mundshëm dhe i provueshëm, njihet e arkëtueshme; përndryshe humbja mbetet shpenzim.
- Shpenzimi nuk është i zbritshëm për qëllime të tatimit mbi fitimin (pa dokumentacion të vlefshëm për shërbim real) - mund të rezultojë tatim fitimi i nënvlerësuar. Faturat janë pa TVSH, prandaj nuk ka TVSH të zbritshme për t'u korrigjuar.
- Nëse humbja ka ndodhur në periudha të mëparshme, korrigjimi bëhet sipas rregullave për gabimet e periudhave të kaluara (nëse është material).

(c) Ndarja e detyrave ndërmjet tre punonjësve:

Punonjësi	**Detyrat**
Punonjësi 1	Lëshimi i porosive te furnitorët dhe marrja në dorëzim e mallrave në magazinë (fletëhyrja).
Punonjësi 2	Regjistrimi i faturave dhe përputhja e trefishtë porosi-fletëhyrje-faturë; rakordimi bankar mujor.
Punonjësi 3 (ose znj. X)	Përgatitja e pagesave në e-banking (pa të drejtë autorizimi përfundimtar) dhe mbajtja e librit të furnitorëve.
Pronari	Krijimi/miratimi i furnitorëve të rinj dhe autorizimi përfundimtar i pagesave.

Parimi: personi që përgatit pagesat nuk krijon furnitorë dhe nuk kryen rakordimin bankar; personi që merr mallrat në dorëzim nuk regjistron faturat.

(d) Kontrolle shtesë nga pronari
- miratim i dyfishtë në e-banking: pronari autorizon çdo pagesë me token-in e vet (përgatitës + miratues);
- pronari miraton personalisht furnitorët e rinj dhe çdo ndryshim të llogarive bankare, pas verifikimit të NIPT-it;

- pronari merr drejtpërdrejt ekstraktet bankare dhe rishikon rakordimin bankar (nënshkrim);
- rishikim mujor i shpenzimeve sipas llojit kundrejt buxhetit dhe periudhës së kaluar, si dhe i listës së furnitorëve të rinj;
- pushime të detyrueshme dhe rotacion detyrash; kontrolle të befasishme surprizë.

Ushtrimi 7.
Shoqëria "ABC" SHPK prodhon motorë të vegjël (motorino), të cilët i shet në shoqëri të tjera që i montojnë ata në produkte, si p.sh. korrëset e barit. Aktualisht shoqëria i prodhon vetë të gjitha pjesët e përdorura në këta motorë, por po shqyrton një propozim nga një furnitor i jashtëm, i cili do të furnizojë shoqërinë me motorinot që përdoret për motorët.
Motorinot aktualisht prodhohen në divizionin 3 të shoqërisë "ABC" SHPK. Kostot e motorinove për 12 muajt e fundit janë si më poshtë:

- Materiale direkte 400,000 lekë
- Puna direkte 300,000 lekë
- Shpenzime e përgjithshme të prodhimit (SHPP) 800,000 lekë
- Totali 1,500,000 lekë

Gjatë vitit të kaluar në divizionin 3 u prodhuan 150,000 motorino. Kosto mesatare për çdo motorino është 10 lekë/njësi(1,500,000 lekë/150,000 njësi).

Analiza e mëtejshme e SHPP zbuloi informacionin e mëposhtëm. Nga SHPP totale, vetëm 25 % konsiderohen variabël. Nga pjesa fikse, 300,000 lekë janë SHPP të shpërndara që nuk do të ndryshojnë edhe nëse motorinot nuk do të prodhohen më. 200,000 lekë të tjera nga SHPP janë të shmangshme nëse ndërpritet prodhimi i motorinove. Teprica e mbetur e SHPP fikse prej 100,000 lekë përfaqëson pagën e menaxherit të divizionit. Nëse "ABC" SHPK ndërpret prodhimin e motorinove, menaxheri i divizionit 3 do të transferohet në divizionin 2 me të njëjtën pagë. Kjo lëvizje do t'i kursente shoqërisë pagën 80,000 lekë për një menaxher të ri të marrë jashtë shoqërisë.

Kërkohet:

a) DEF Sh.p.k., një furnitor i besueshëm ka ofruar të furnizojë shoqërinë me motorino me çmimin 8 lekë/njësi. Për shkak se ky çmim është më i ulët se kosto mesatare aktuale prej 10 lekë/njësi, zëvendëspresidenti i prodhimit është i prirur për të pranuar ofertën. Mbështetur vetëm në të dhëna financiare, a duhet të prodhohet vetë motorino apo të blihet nga furnitori i jashtëm?
b) Si do të ndryshonte përgjigja juaj në kërkesën 1, nëse shoqëria do të përdorte hapësirën e fabrikës së mbetur bosh për magazinim, e në këtë mënyrë do të shmangte 100,000 lekë kosto magazinimi që aktualisht kryhen jashtë ambjenteve të shoqërisë.

Zgjidhje:
Analiza e kostove (për 150.000 njësi në vit):

Zerat	Prodhoj	Blej	Shpjegim
Materiale direkte	400,000	0	Shmanget nëse blihet.
Pune direkte	300,000	0	Supozohet e shmangshme.
SHPP variabel	0.25*800,000=200,000	0	Shmanget.
SHPP fikse te pashmangshme	300,000	300,000	Nuk ndryshojnë - kosto e pashmangshme.
SHPP fikse te shmangshme	200,000	0	Shmangen nëse ndërpritet prodhimi.
Paga e menaxherit (divizioni 3)	100,000	0	Paguhet gjithsesi (transferohet në divizionin 2).
Paga e menaxherit (divizioni 2)	80,000	100,000	Kosto oportune e prodhimit: nëse prodhohet, shoqëria duhet të punësojë menaxher të ri për 80,000.
Kosto blerje motorino	0	150,000*8=1,200,000	
Kosto totale	**1,580,000**	**1,600,000**	

(a) Vendimi

Bazuar në analizën e të dhënave financiare për të dyja alternativat, shoqëria ABC do të zgjedhë që ta prodhojë vetë pjesën.

Krahasimi i zëvendëspresidentit me koston mesatare të plotë (10 lekë/njësi) është i gabuar, sepse përfshin kosto të pashmangshme (si 300,000 SHPP fikse të shpërndara dhe pagën e menaxherit).

(b) Me kursimin e kostos së magazinimit
Nëse blihen, shmangen edhe 100,000 lekë kosto magazinimi. Vendimi ndryshon: motorinot duhet të blihen nga DEF sh.p.k., me kursim 80,000 lekë.

Zërat	Prodhoj	Blej
Kosto totale	1,580,000	1,600,000
Kosto magazinimi	100,000	0
Kosto totale	**1,680,000**	**1,600,000**

Shënim: Do të vlerësohet edhe zgjidhja me llogaritje të kostove të rëndësishme të vendimmarrjes.

Ushtrimi 8.

Shoqëria "ABC" Sh.p.k., prodhon dy produkte, A dhe C. Informacioni për vitin 2024 është:

Treguesi	Vlera
Prodhimi i produktit A	640 njësi
Prodhimi i produktit C	350 njësi
Kostoja totale	672,000 $
Përqindja e kostove variabël	75%
Pjesa e kostove variabël që i përket A	60%
Pjesa e kostove variabël që i përket C	40%

Për vitin 2025 parashikohet rritje e kostove për njësi prej 4%. Prodhimi i planifikuar është 750 njësi për A dhe 340 njësi për C. Eficienca mbetet e pandryshuar.

Kërkohet:

a) Llogaritni koston variabël totale të produktit C në vitin 2024.
b) Llogaritni koston variabël për njësi të produktit C.
c) Përcaktoni koston variabël të buxhetuar të produktit C për vitin 2025.

Zgjidhje:

Kostoja variabël e produktit C
(a) Kostoja variabël totale e C në 2024: kostot variabël totale = 672,000 × 75% = 504,000 $; pjesa e C = 504,000 × 40% = 201,600 $.
(b) Kostoja variabël për njësi e C: 201,600 / 350 = 576 $/njësi.
(c) Kostoja variabël e buxhetuar për 2025: kostoja për njësi 576 × 1.04 = 599.04 $/njësi; kostoja totale = 599.04 × 340 = 203,673.60 $.

Ushtrimi 9.

"ABC" SHPK prodhon dhe shet bukë. Për muajin janar 2025 buxheti për të blerë dhe për të përdorur 15,000 kg miell është 0.89 lekë/kg. Blerjet faktike dhe përdorimi për muajin janar 2025 për miellin ishin 16,000 kg me një çmim prej 0.82 lekë/kg. "ABC" SHPK buxhetoi 60,000 bukë. Prodhimi faktik ishte 60,800 bukë.

Kërkohet:

a) Llogarisni shmangien e buxhetit fleksibël për materialin direkt.
b) Llogarisni shmangien e çmimit dhe të përdorimit për materialin direkt.
c) Shpjegoni arsyet e mundshme të shmangieve të konstatuara në kërkesat e mësipërme.

Zgjidhje:
(a) Shmangia e buxhetit fleksibël

Të dhënat kryesore janë:

Treguesi	Faktike	Të buxhetuara
Njësi të prodhuara (bukë)	60,800	60,000
Sasia e materialit të përdorur (kg miell)	16,000	15,000
Kostoja për njësi materiali	0.82 $	0.89 $

Shoqëria "ABC" ka buxhetuar 0.25 kg miell per nje buke. (15 000 kg/60 000 buke=0.25 kg/buke)

Tabela e analizës së shmangieve

Përshkrimi	Rezultatet faktike (1)	Shmangia e buxhetit fleksibël (2) = (1) − (3)	Buxheti fleksibël (3)	Shmangia e vëllimit të prodhimit (4) = (3) − (5)	Buxheti statik (5)
Kostoja e miellit	13,120 $	408 $ F	13,528 $	178 $ JF	13,350 $

Llogaritjet:

a. Kostoja faktike:
16,000 × 0.82 $ = 13,120 $
b. Buxheti fleksibël:
60,800 × 0.25 × 0.89 $ = 13,528 $
c. Buxheti statik:
60,000 × 0.25 × 0.89 $ = 13,350 $
Shmangia e buxhetit fleksibël:
13,120 $ − 13,528 $ = −408 $ = 408 $ e favorshme (F)
Shmangia e vëllimit të shitjes:
13,528 $ − 13,350 $ = 178 $ = 178 $ jo e favorshme (JF)

(b) Shmangia e çmimit dhe e përdorimit

Për analizën e shmangieve të materialit direkt krahasohen tri vlera:

Kostoja faktike (Sasia faktike × Çmimi faktik)	Sasia faktike × Çmimi standard	Buxheti fleksibël (Sasia standarde e lejuar për prodhimin faktik × Çmimi standard)
13,120 $	14,240 $	13,528 $

a) Shmangia e çmimit të materialit direkt:
Shmangia e çmimit = Sasia faktike × (Çmimi faktik − Çmimi standard)
= 16,000 × (0.82 $ − 0.89 $)
= 16,000 × (−0.07 $)
= −1,120 $
Shmangia e çmimit = 1,120 $ e favorshme (F).

b) Shmangia e eficiencës së materialit direkt
Fillimisht llogaritet sasia standarde e materialit që duhej përdorur për prodhimin faktik.
Sasia standarde e lejuar = 60,800 × 0.25 = 15,200 kg

Shmangia e eficiencës = (Sasia faktike − Sasia standarde e lejuar) × Çmimi standard
= (16,000 − 15,200) × 0.89 $
= 800 × 0.89 $
= 712 $ jo e favorshme (JF).

c) Arsyet e mundshme
A) **Çmimi i favorshëm:** blerje mielli me cilësi më të ulët; zbritje për sasi ose furnitor i ri; rënie e çmimeve në treg; standard i vendosur shumë lart (i papërditësuar).
B) **Përdorimi i pafavorshëm:** mielli më i lirë dhe me cilësi më të ulët shkakton fire dhe skarcitet më të madh (shmangiet janë të ndërvarura); punonjës të pakualifikuar ose joefiçentë; defekte në pajisje; humbje, prishje ose vjedhje e materialit; standard i paarritshëm.
C) Shmangiet duhet të analizohen së bashku: përfitimi nga çmimi mund të jetë kompensuar pjesërisht nga përdorimi më i lartë dhe mund të ndikojë cilësinë e produktit.